

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Keshilli i Ministrave

VENDIM  
Nr. 604, date 28.8.2003

PER MIRATIMIN, NE PARIM, TE KODIT TE SJELLJES SE BASHKIMIT EUROPIAN PER  
EKSPORTIN E ARMEVE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te neneve 5 e 6, te ligjit nr.8371, date 9.7.1998,  
"Per lidhjen e traktateve dhe marreveshjeve nderkombetare", me propozimin e ministrit te  
Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, ne parim, te kodit te sjelljes se Bashkimit European per eksportin e armeve.  
Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI  
FATOS NANO

MINISTER I MBROJTJES  
PANDELI MAJKO

**KODI I SJELLJES  
SE BASHKIMIT EVROPIAN PER EKSPORTIN E ARMEVE  
KESHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN**

MBI BAZEN e Krieteve te perbashketa, per te cilat u ra dakord ne mbledhjet e Keshillit  
Evropian ne Lisbona dhe Luksemburg me 1991 dhe 1992

DUKE NJOHUR pergjegjesine e vecante te shteteve eksportuese te armeve.

IVENDOSUR te percaktoje standarde te perbashketa te larta, te cilat du-het te konsiderohen  
si minimum per administrimin dhe kufizimin e tregtise se armeve konvencionale nga te  
gjitha Shtetet Aletate dhe te permiresoje sh-kembimin e infomacionit perkates per te arritur  
nje transp, irence me te mad-he.

I VENDOSUR te ndaloje eksportin e pajisjeve, te cilat mund te perdoren per represion te  
brendshem, ne nje agresion nderkobetar, apo qe mund te shkaktojne situatate te  
paqendrueshme rajonale.

ME VULLNETIN qe te forcoje bashkepunimin dhe te inkurajoje konvergimin ne fushen e  
eksportit te armeve konvencionale, ne kuadrin e Politikes se Perbashket per ceshtjet e  
Jashtme dhe Sigurine (CFSP).

DUKE PRANUAR masat plotesuese qe jane marre kunder tregtise se paligjshme ne kuadrin e Programit te BE-se per Parandalimin dhe Luften kunder Trafikut te Paligjshem te Armeve Konvencionale,

DUKE NJOHUR deshiren e Shteteve Anetare per te ruajtur industrine e mbrojtjes si hallke te bazes se tyre industriale si dhe te perpjekjeve ne fushen e mbrojtjes.

DUKE U NJOHUR Shteteve te drejten per te transferuar mjetet e vetem-brojtjes, ne perputhje me te drejten per vetembrojtje te sanksionuar ne Karten e OKB-se.

KA HARTUAR Rregulloren e meposhtme bashke me dispozitat:

### **Kriteri Nje**

Respektimi i angazhimeve nderkombetare te Shteteve Anetare, ne vecanti sanksionet e miratuara nga Keshilli i Sigurimit i OKB-se dhe nga Bashkimi Evropian, marreveshjet per mosperhapjen e armeve dhe geshtje te tjera si dhe i detyrimeve te tjera nderkombetare.

Leja per eksportin duhet te refuzohet nese aprovimi i saj nuk perputhet, nder te tjera:

- a) me detyrimet nderkombetare te Shteteve Anetare dhe angazhimet e tyre per zbatimin e embargove te armeve te OKB-se, OSBE-se dhe BE-se;
- b) me detyrimet nderkombetare te Shteteve Anetare ne kuadrin e Traktatit per Mosperhapjen e Armeve Berthamore, Konventes se Armeve Biologjike dhe Toksike dhe Konventes se Armeve Kimike;
- c) me angazhimet e Shteteve Anetare ne kuadrin e Grupit te Australise, Regjimit te Kontrollit te Teknologjise se Raketave, Grupit te Furnizuesve Berthamore dhe Marreveshjes se Wassenaar-it;
- d) me angazhimin e Shteteve Anetare per te mos eksportuar asnje lloj mine kunder trupave te kembesorise.

## **KRITERI DY**

Respektimi i te drejtave te njeriut ne vendin qe eshte destinacioni i fundit.

Pasi te kene vleresuar qendrimin e vendit importues ndaj parimeve per-katese te percaktuara nga instrumentet nderkombetare te te drejtave te njeriut, Shtetet Anetare:

a) nuk do te japin leje per eksport, ne qofte se ekziston nje rrezik i qarte per pajisjet qe propozohen te eksportohen, mund te perdoren per represion i brendshem,

b) do te kene vigjilence dhe kujdes te vegante ne leshimin e lejes se eksportimit, duke vleresuar rast pas rasti dhe duke marre parasysh natyren e pajisjeve per ato vende, ne te cilat organizmat kompetente te OKB-se, Keshillit te Evropes apo te BE-se kane regjistruar shkelje te rendit te drejtave te njeriut;

Ne kete kuader, ne pajisjet qe mund te perdoren per represion te brendshem do te perfshihen, nder te tjera, ato pajisje, apo pajisje te ng-jashme, per te cilat ka prova qe bleresi i propozuar i ka perdorur per represion te brendshem, ose kur ka aresye te besohet se pajisjet do te transferohen nga bleresi i propozuar ne nje vend tjetere, dhe mund te perdoren per represion te brendshem. Ne perputhje me paragrafin 1 te dispozitave te kesaj Rregulloreje, natyra e pajisjes do te shqyrtohet me kujdes, veganerisht kur qellimi i perdorimit te saj eshte per sigurine e brendshme. Ne represionin e brendshem perfshihen, nder te tjera, tor-tura dhe forma te tjera mizore gjerezore dhe poshteruese te trajtimit apo ndeshkimit, ekzekutimet arbitrare apo pa gjyq, zhdukjet e person-ave, ndalimet arbitrare dhe shkelje te tjera te medha te te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, sig jane percaktuar ne dokumentet perkatese nderkombetare per te drejtat e njeriut, perfshire Deklaraten Univer-sale per te Drejtat e Njeriut dhe Konventen Nderkombetare per te Drejtat Qytetare dhe Politike.

## **KRITERI TRE**

Situata e brendshme ne vendin qe eshte destinacioni i fundit, ne kuptimin e ekzistences se tensioneve apo konflikteve te armatosura.

Shtetet Anetare nuk do te lejojne eksportet qe mund te nxisin apo zgjasin konflikte te armatosura, apo te acarojne tensionet ose konflikte te ekzistuese ne vendin qe eshte destinacioni i fundit.

## **KRITERI KATER**

Ruajtja e paqes, sigurise dhe stabilitetit rajonal.

Shtetet Anetare nuk do te japin leje eksporti, ne qofte se ekziston nje rrezik i qarte se bleresi mund t'i perdore pajisjet qe propozohen per eksport ne menyre agresive kunder nje vendi tjetere ose per te zgjidhur me force nje pretendim territorial.

Kur te analizojne kete rrezik. Shtetet Anetare do te marrin parasysh, nder te tjera:

a) ekzistencen ose gjasat e nje konflikti te armatosur mes bleresit dhe nje vendi tjetere;

b) ndonje pretendim territorial ndaj nje vendi fqinj, te cilin bleresi ne te kaluaren eshte perpjekur apo ka kercenuar ta zgjidhe me ane te forces;

- c) nese ka gjasa qe pajisja te perdoret nga bleresi per qellime te tjera perveg aspektit te ligjshem te sigurise kombetare dhe mbrojtjes;
- d) nevojten per te mos ndikuar negativisht mbi stabilitetin rajonal.

### **KRITERI PESE**

Siguria kombetare e Shteteve Anetare dhe e territoreve, per te cilat Shtetet Anetare kane pergjegjesi per marredheniet me jashte, si dhe siguria e vendeve mike dhe aleate.

Shtetet Anetare do te marrin ne konsiderate:

- a) ndikimin e mundshem te eksportit qe propozohet mbi interesat e tyre te sigurise dhe mbrojtjes, ato te vendeve mike, aleate dhe Shteteve te tjera, Anetare, duke pranuar se ky faktor nuk mund te ndikojte mbi shqyrtimi e kriterit per respektimin e te drejtave te njeriut dhe ruajtjen e paqes, si dhe stabilitetit rajonal;
- b) rrezikun qe mallrat ne fjale te perdoren kunder forcave te tyre apo te vendeve mike aleate apo te Shteteve te tjera Anetare;
- c) rrezikun e transferimit te teknologjise pa dashur.

### **KRITERI GJASHTE**

Qendrimi i vendit bleres ne lidhje me bashkesine nderkombetare, veçanerisht qendrimi ndaj terrorizmit, natyra e aleancave qe ai vendos dhe respektimi i te drejtave nderkombetare

Shtetet Anetare do te marrin ne konsiderate, nder te tjera, te kaluaren e vendit bleres persa i perket:

- a) mbeshtetjes apo inkurajimit qe ai i ka dhene terrorizmit dhe krimin te organizuar nderkombetar;
- b) permbushjes se angazhimeve nderkombetare, veganerisht per mosperdorimin e forces, perfshire ligjin humanitar nderkorabetar per konfliktet nderkombetare dhe jonderkombetare;
- c) angazhimit te tij per mosperhapjen e armeve dhe aspektet e tjera te kon-trollit te armeve dhe çarmatimit, veçanerisht nenshkrimi, ratifikimi dhe zbatimi i konventave perkatese per kontrollin e armeve dhe çarmatimit te permendura ne piken b) te Kriterit Nje.

### **KRITERI I SHTATE**

Ekzistenca e rrezikut, qe pajisjet te shperndahen brenda vendit bleres ose te eksportohen ne kushte te padeshirueshme. Ne vleresimin e ndikimit te eksportit te presupozuar ne vendin importues dhe rrezikut, qe mallrat e eksportuar mund te shperndahen te nje perdorues i padeshirueshem, duhet te merren ne konsiderate sa vijon:

- a. interesat legjitime te mbrojtjes dhe sigurise se vendit marres, duke perfshire çdo angazhim te OKB-se ose aktivitet tjeter paqeruajtes.
- b. kapacitetet teknike te vendit marres per te perdorur pajisjet.
- c. kapacitetet e vendit marres per te ushtruar kontroll efektiv te eksportit.
- d. rrezikun e rieksporimit te armeve ose dhenien organizatave terroriste (pajisjet antiterroriste kane nevojte vecanerisht per nje konsiderate te kujdesshme ne kete kontekst)

## **KRITERI I TETE**

Pershtatja e eksportit të armëve me kapacitetin teknik dhe ekonomik të vendit marrës, duke mbajtur parasysh dëshirën që shtetet duhet të arrijnë nevojat e tyre legjitime të sigurisë dhe të mbrojtjes me një harxhim sa më të pakët të burimeve njerezore dhe ekonomike për armatimet.

Shtetet Anetare do të marrin parasysh, në dritën e informacionit nga burimet perkatese të tilla si raportet e PNUD-it, Bankes Botërore, FMN-se dhe DECD-s nëse eksportet e propozuara mund të pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit marrës ata do të marrin në konsideratë në këtë kontekst nivelet relative të shpenzimeve ushtarake dhe sociale të vendit marrës, duke marrë parasysh gjithashtu çdo ndihmë të BE-se ose dypalesh.

## **DISPOZITA**

1. Qdo Shtet Anetar do t'i shqyrtojë kërkesat që i paraqiten për eksportim të pajisjeve ushtarake rast pas rasti në përputhje me dispozitat e Rregullores.
2. Rregullorja nuk do të cenohet të drejtën e Shteteve Anetare për të zbatuar politikë kombëtare me kufizuese.
3. Shtetet Anetare do të qarkullojnë përmes kanaleve diplomatike hollësi për lejet e refuzuara në përputhje me Rregulloren për pajisjet ushtarake si dhe arsytet e refuzimit. Hollësi që duhet të behen të ditura jepën në një projekt-formular në Shtojcën bashkelidhur. Përpara se një Shtet Anetar të leshojë një leje, e cila është refuzuar nga një Shtet apo Shtete të tjera Anetare për një transaksion në thelb të njëjtte gjatë tre vjeteve të fundit, ai duhet të konsultohet me Shtetin apo Shtetet Anetare që kanë bërë refuzimin. Në qoftë se pas këtyre konsultimeve, Shteti Anetar vendos që ta japë lejen, ai duhet të njoftojë Shtetin apo Shtetet Anetare që kanë bërë refuzimin, duke dhënë hollësi për këtë.  
Vendimi për të transferuar apo refuzuar transferimin e pajisjeve ushtarake u mbetet Shteteve Anetare mbi bazën e interesave kombëtare. Refuzimi i lejes do të quhet momenti kur një Shtet Anetar refuzon të autorizojë shitjen faktike apo eksportimin fizik të pajisjes ushtarake në fjalë, kur shitja, përndryshe, do të ishte kryer, ose përfundimi i kontratës perkatese. Në këtë kuader, mbi bazën e procedurave kombëtare, refuzimi mund të përfshijë mosdhenien e lejes për fillimin e negociatave apo dhenien e një përgjigjeje negative ndaj një kërkesë zyrtare paraprake për një porosi të veçantë.
4. Shtetet Anetare do të ruajnë konfidencialitetin e këtyre refuzimeve dhe konsultimeve dhe nuk do t'i shfrytëzojnë ato për avantazhe tregtare.
5. Shtetet Anetare do të punojnë për miratimin e shpejtë të një liste pajisjesh ushtarake që përfshihen në Rregullore, bazuar mbi listën e ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. Deri atëherë, Rregullorja do të veprojë mbi bazën e listave kombëtare të kontrollit, duke përfshirë në ato raste kur duhet, elemente nga listat perkatese ndërkombëtare.
6. Kriteret e Rregullores dhe procedura e konsultimit të parashtruar në paragrafin 3 të Dispozitave vlejnë edhe për mallrat me përdorim të dyfishtë, siç specifikohet në Shtojcën I të Vendimit të Këshillit 94/942/CFSP (1), kur ka arsye të besohet se këto mallra do të përdoren nga forcat e armatosura, forcat e sigurimit apo entiteteve të ngjashme në vendin blerës.
7. Për të rritur efektshmërinë e Rregullores, Shtetet Anetare do të punojnë në kuadrin e CFSP-se për të forcuar bashkëpunimin mes tyre dhe për të inkurajuar procesin e konvergimit në fushën e eksportit të armëve konvencionale.

8. Cdo Shtet Anetar do te qarkulloje me konfidencialitet te Shtetet e tjera Anetare nje raport vjetor per eksportet ne fushen e mbrojtjes dhe per zbatimin e Rregullores prej tij. Keto raporte do te diskutohen ne nje mbledhje vjetore ne kuadrin e CFSP-se. Ne kete mbledhje do te shqyrtohet edhe zbatimi i Rregullores, do te identifikohen permiresimet qe duhen bere, dhe do t'i paraqitet Keshillit nje raport i plote, mbi bazen e kontributit te Shteteve Anetare.

9. Shtetet Anetare, kur duhet, do te vleresojne bashkerisht ne kushtet e CFSP-se situaten ne vendet ku Shtetet Anetare eksportojne arme aktualisht apo jane bleres potenciale, nen driten e parimeve dhe kriterëve te Rregullores.

10. Pranohet se Shtetet Anetare, ne raste te pershtatshme, mund te marrin parasysh pasojat e eksporteve te propozuara mbi interesat e tyre ekonomike, shoqerore, tregtare dhe industriale, por keta faktore nuk do te ndikojne mbi zbatimin e kriterëve te mesiperme.

11. Shtetet Anetare do te bejne perpjekje maksimale per te inkurajuar shtete te tjera eksportuese armesh qe te pranojne parimet e Rregullores.

12. Rregullorja dhe Dispozitat zevendesojne te gjitha klauzolat e meparshme te Kriterëve te Perbashketa te vitit 1991 dhe 1992.

## SHTOJCE

### Hollesite qe duhen njoftuar

.....(emri i Shtetit Anetar) ka nderin te informoje partneret per refuzimin e meposhtem ne perputhje me Rregulloren e BE-se.

Vendi i destinacionit:.....

Pershkrim i shkurter i pajisjes, perfshire sasine dhe, kur eshte e pershtatshme, te dhenat teknike:.....

Pritesi i propozuar i mallit:.....

Perdoruesi i propozuar (n.q.s. eshte tjeter):.

Arsyja e refuzimit:.....

Data e refuzimit:...